



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802087/4

Tiranë ___/___/2018

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën "Mehmet Ali Vrioni", për mbështetjen e nxënësit me inicialet E.K.

DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE

ZOTIT SELMAN HODAJ

BERAT

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës si dhe, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Dritan Kurti. Kjo ankesë adreson problematikën e hasur, në drejtim të plotësimit të normës së parashikuar nga Komisioni Multidisiplinar pranë Drejtorisë Rajonale Arsimore, Berat për mbështetjen me mësues ndihmës të nxënësit me inicialet E.K. në shkollën 9-vjeçare "Mehmet Ali Vrioni". Situata e krijuar në këtë rast passjell frekuentimin e shkollës nga nxënësi vetëm një herë në javë.

Në shkresën zyrtare me nr. K5/D3-2 prot., datë 21.11.2018, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi informacion, lidhur me problematikën e ngritur nga ana e shtetasit Kurti.

Në përgjigje të shkresës zyrtare me nr.1439/1prot., datë 27.11.2018, Drejtorja Arsimore Rajonale Berat na informoi si më poshtë vijon:

- Nxënësi me inicialet E.K është vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale, Berat, ku në Planin Edukativ të Individualizuar të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të fëmijës

është vendosur mbështetja me mësues ndihmës dy orë në ditë. Konkretisht, nxënësi me inicialet E.K mbështetet me katër orë në javë me mësues ndihmës, pra gjysma e normës së parashikuar nga Komisioni Multidisiplinar në Planin Edukativ të Individualizuar. Mësuesja ndihmëse, e caktuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Berat, në shkollën 9-vjeçare “Mehmet Ali Vrioni” mbështet 6 nxënës me aftësi të kufizuara të kësaj shkolle, ku përfshihet edhe nxënësi me inicialet E.K. Në zbatim të udhëzimit nr.30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, , norma e parashikuar për mësuesit ndihmës nuk mbulon të gjitha nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në këtë shkollë, në përputhje me Planet Edukative të Individualizuara të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të çdo fëmije.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e mirë, të nisur nga Drejtoria Arsimore Rajonale Berat, për të përmbushur të drejtën e çdo fëmije për t’u arsimuar, siç e parasheh neni 18, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Ju rekomandojmë marrjen e masave, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit tek fëmijët me aftësi të kufizuara dhe, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve. Më konkretisht, për këtë qëllim,

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën “Mehmet Ali Vrioni”, për të mbështetur nxënësin me inicialet E.K me mësues ndihmës, dy orë në ditë, me qëllim realizimin e masave të parashikuara në Planin Edukativ të Individualizuar të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të fëmijës nga Komisioni Multidisiplinar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale, Berat.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditë nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R I

Nejla PEKA